



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 67

Prishtinë, më 22.3.2017 në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: nënkryetari i parë i komisionit, Agim Çeku, nënkryetarja e dytë Mufera Shinik, dhe anëtarët e komisionit : Kimete Bytyçi, Fisnik Ismaili, Ali Berisha, Çerim Bajrami dhe Danush Ademi.

Munguan: Jasmina Živković, Milka Vuletić, Saša Milosavljević, Slavko Simić dhe Veton Berisha.

Pjesëmarrës të tjerë: Senad Karaahmetovic, përfaqësues i OSBE-së; Hajrudin Skenderi, përfaqësues i Ambasadës Zvicrane; Zijush Ahmeti, konsultant i Sekretariatit të KKK-së dhe Celal Iliaz, Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Agim Çeku, nënkryetar i komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-118 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-139 për procedurën përmbarimore me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-105 për Mbrojtjen e Fëmijës, me amendamente e Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione;
4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-143 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-21 me amendamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Nënkryetari, konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-118 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-139 për procedurën përmbartimore me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit;

Nënkryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin Nr. 05/L-118 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-139 për procedurën përmbartimore dhe kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohen nëse kan ndonjë propozim apo sygjërim në raportin me amendamente të Komisionit Funksional.

Pas shqyrtimit të Projektligjit dhe Raportit me amendamente të Komisionit Funksional, Komisioni nxorri këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin Nr. 05/L-118 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-139 për procedurën përmbartimore dhe konstaton se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-105 për Mbrojtjen e Fëmijës, me amendamente e Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione;

Nënkryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjit nr. 05/L-105 për Mbrojtjen e Fëmijës me raport amendamente të Komisionit Funksional dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Pas shqyrtimit të Projektligjit dhe Raportit me amandamente të Komisionit Funksional, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L-105 për Mbrojtjen e Fëmijës dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-143 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-21 me amendamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së;

Nënkryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.05/L-143 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror dhe konstatoi se Komisionit Funksional nuk ka paraqit amendamente në këtë projektligj.

Meqë nuk kishte vërejtje, nënkryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime, nxorri këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr.05/L-143 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror dhe vlerëson se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe si i till mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

5. Të ndryshme.

Me rastin e kësaj pike të rendit të ditës, nënkryetari **z. Agim Çeku**, kujtoi anëtarët e Komisionit që në kuadër të kopetencave të veta mund të rishqyrtoj Planin e Punës, me arsye të vlerësohen të arriturat dhe mangësit e gjashtëmujorit të vitit kalendarik. Për plotësimin dhe ndryshimin e planit të punës, dha si propozim konkret që të organizohet puntoria dy ditore, me mundësi të mbahet në KK Prizren. Gjegjësisht për realizimin e puntorisë kërkoi mbështetjen nga misioni i OSBE-së.

Senad Karaahmetovic, në diskutimin e tij tha se në këtë vit, misioni i OSBE-së, në kuadër të mbështetjes së këtij komisioni ka parapar ndarjen buxhetore për organizimin e tri vizitave, në KK të Prizrenit, KK të Pejës dhe në KK të Mitrovicës. Dha sqarim se në agjendën e OSBE-së nuk është planifikuar puntoria dy ditor , dhe për organizmin e të njejtës nevojitet kohë, për këtë arsye kërkoi të marr përkrahjen e komisionit, me mundësi që puntoris e punës të mbahet nga mesi i muajit prill.

Nënkryetari, sugheroj që në kuadër të realizimit të puntorisë dy ditore, Komisioni në ditën e parë të vizitës në Prizren, të tekë biseda të përbashkëta me të gjitha komunitetet joshumicë, ndërsa në ditën e dytë, të zhvillohen aktivitetet e komisionit lidhur me plotësimin dhe ndryshimin e planit të punës për vitin 2017.

Çerim Bajrqami, ishte i të njejtit mendim që vizita të realizohet në qytetin e Prizrenit duke elaburuar se në këtë komunë zhvillohet jetesa e një numër më të madh të komuniteteve joshumicë dhe ëshë mirë të ndëgjohen kërkesat, sygjerimet dhe vërejtjet e tyre, ndërsa në ditën e dytë të punohet në plotësimin dhe ndryshimin e planit të punës.

Kimete Bytyqi, bazuar në çështjen e ngritur nga parafolësit, pajtohet plotësisht që vizita të realizohet në qytetin e Prizerenit dhe si kërkesë e saj ishte që në të njejtën ditë të vizitohet komuna e Restelicës, ndërsa në ditën e dytë të shyrtohet plani i punës.

Myfera Sinik, ndau mendimin e njejtë që në fazën e parë të vizitohet qyteti i Prizrenit pasi në këtë komunë dhe rrethina jetojnë komunitetet joshumicë dhe kërkesat janë të natyrave të ndryshme dhe mirë është që të ndëgjohen zërat e tyre .Ajo dëshiron të jetë prezente kur të realizohet vizita në Prizren dhe për arsye të agjendës së saj propozoi që puntoria e punës të caktohet në periudhën e dytë të muajit prill.

Nënkryetari , sa i përket propozimit për vizitën në komunën e Restelicës, ai konsideron se mirë është që i njehti të planifikohet për një ditë tjetër.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimeve , nënkryetari konstatoi se Komisioni unanimisht, nxorri këtë:

Përfundim

Obligohet, administrata për mbështetje të komisionit të kontaktojë me përfaqësuesin e misionit të OSBES-së që të hartojnë draft programin me referenca të nevojshme me qëllim të realizimit të puntëorisë së punës, për periudhën e dytë në muajin prill, të këtij viti.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit.

Nënkryetar i Komisionit,

Agim Çeku